



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Procesverbal

nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 23 dhjetor 2024

Takimi filloi në orën 14.30

Takimin publik e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (35 pjesëmarrës);

Nënkryetarja e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësues të OJQ-ve dhe mediat.

Tema:

Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara për vitin 2024

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, qytetarë të nderuar ju përshëndes të gjithëve dhe ju falënderoj që keni ndarë kohën që bashkërisht të bëjmë shpalosjen e punës të ekzekutivit të Komunës së Podujevës për vitin 2024. Me që jemi në fund vit ju kam ftuar që bashkërisht të diskutojmë punët e pse jo edhe sugjerimet e eventualisht edhe pengesat të cilat na kanë përcjellë gjatë vitit 2024. Mund të ju them se po përmbyllem një vit, sigurisht me një varg projektesh të rëndësishme në interes të qytetarëve tanë, por edhe një vit i cili ka qenë relativisht sfidues, me një varg sfidash si në aspektin objektiv e nganjëherë edhe të aspektit subjektiv por që shpresoj se me një angazhim të përbashkët të gjithë neve kemi arritur të shtyjme një varg punësh dhe aktiviteteve të cilat seriozisht besoj kanë lehtësuar jetën e qytetarëve. Unë po bëj përpjekje që të numëroj disa prej punëve por edhe projekteve të rëndësishme ku mendoj që kanë qenë shumë të rëndësishme dhe shumë të pritura për qytetarët tanë dhe besoj që suksesshëm kanë ndikuar të përmbyllet ky vit.

Atëherë të fillojmë sipas Drejtorive;

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Është Drejtori e cila ka bërë përpjekje të realizojë punët dhe angazhimet të cilat janë pjesë e domenit të kësaj Drejtorie.

Sektori i Gjendjes Civile

• Certifikata të lëshuara: Certifikata të ndryshme të gjendjes civile 74,479; Certifikata Originale (jashtë vendit) 30,968; Certifikata (brenda vendit) 43,510; Martesa të reja 855; Vdekje të lajmëruara 310; Lindje të lajmëruara në QKMF Podujevë 620; Lindje jashtë vendit 620; Martesa jashtë vendit 87; Vdekje jashtë vendit 42; Aktvendime për regjistrim (Regjistrim lindjeje, vdekjeje, ndryshim emri 252).

Është bërë një investim në kuptimin e investimeve kapitale, rregullimi i oborrit të Komunës sonë dhe besoj që edhe ky vit kjo Drejtori suksesshëm e ka përmbyllur duke i shërbyer kujdesshëm dhe me kohë reale gjithë ato kërkesa që janë parashtruar para kësaj drejtorie.

DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCAVE

Është planifikuar dhe aprovuar buxheti për vitin 2025, buxheti me i lartë në historinë e Komunës së Podujevës në vlerë prej 33,459,115.00 €, buxhet që është 2,416,096.00 euro më i lartë se buxheti i vitit 2024.

Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës të realizuara në vitin 2024, janë afër 2.3 milion euro, pra kemi një tejkalim të hyrave vetanake prej 400 mijë euro.

Këto mjete do ti shtohen buxhetit të vitit 2025 për realizimin e projekteve të rëndësishme për qytetarët tonë.

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar 1600 objekte në sistemin e tatimit në pronë, që do të ndikojë pozitivisht në rritjen e të hyrave vetanake në vitin 2025. Vet fakti i regjistrimit të këtyre objekteve të reja, nënkupton që viti vijues të jetë vit me të hyra vetanake më të larta.

DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtorja e Arsimit është një prej drejtorive që suksesshëm po e përmbyll këtë vit me një varg punësh dhe projektesh të rëndësishme të cilat kanë ndihmuar të përmirësohen kushtet çoftë në mësim zënie qoftë në mësimdhënie, duke investuar një varg të investimeve çoftë të mallra e shërbimeve ashtu edhe të investimeve kapitale.

Në aspektin e përmirësimit të infrastrukturës shkollore është realizuar një projekt në vlerë prej 152,952.74 euro, projekti i cili relativisht shumë ka ndikuar në përmirësimin e hapësirave arsimore në Komunën tonë.

Po theksoj në vijim edhe projektet tjera të realizuara:

Furnizim me kompjuterë për shkolla – Aktiviteti është përfunduar, me një vlerë financiare prej 171,010.00 euro.

Kemi një projekt tjetër që është ende aktual në faza të realizimit ndërtimi i rrethojave të shkollave ë vlerë prej 52934.8 €.

Gjatë këtij viti kemi arritur të përmbyllim suksesshëm ndërtimin e SHFMU “Ali Hadri” në fshatin Obranqë në vlerë përafërsisht rreth 500,000 €.

Ndërtimi i shkollës “Musli Dumoshi” në Dumosh – Projekti ka përfunduar, me një vlerë financiare prej 562,305.74 euro.

Ndërtimi i shkollës “Hasan Ramadani” në Shajkoc – Kontrata është nënshkruar dhe punimet janë duke vazhduar. Vlera financiare e projektit është 594,444 euro.

Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike, projekt i cili realizohet komplet nga buxheti vetanak i Komunës në vlerë prej 2,566,649.05 euro, është fjala për ndërtimin e objektit të ri të shkollës së mesme profesionale “Isa Boletini” Podujevë.

Në bashkëpunim dhe koordinim me MASHTI-në kemi nënshkruar një kontratë për fillimin e punëve për ndërtimin e objektit të ri të shkollës së kompetencës me një vlerë kontrate prej 2,430,000 € dhe ky investim është nga MASHT-i.

Ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën “Ali Ajeti” në Sfeçël, projekt bashkëfinancim me MAPL-në, në fazën e realizimit, me një vlerë kontrate prej 373,787 euro.

Renovimi dhe adaptimi për çerdhe i objektit të vjetër të shkollës “Hamit Sejdiu” në Kerpimeh , projekti është në fazën e realizimit, në vlerë kontrate prej 193,615 euro, nga mjetet vetanake të Komunës, projekt i cili pritet të përfundojë në fillim të vitit të ardhshëm.

Furnizimi për perde për shkolla, projekt i përfunduar për nevoja të shkollave tona , në vlerë prej 28,711.05 € dhe është projekt që e realizojnë nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Fan S. Noli “ dhe të cilët prodhojnë duke kryer praktikën e tyre profesionale për nevoja të shkollave tjera.

Ndërtimi i sallës sportive në shkollën “Enver Maloku”, projekti është në fazën e përfundimit, në vlerë prej 215,488.48 €.

Furnizimi me kabinete për lëndët gjeografi, histori dhe matematikë , i realizuar në vlerë prej 52,997.47 €, është fjala për mjete të ndryshme konkretizimi.

Furnizimi me shporta për mbeturina, projekt i përfunduar vlerë prej 12,300 euro, projekt ku për herë të parë po aplikohet në institucionet e Komunës tonë, fjala është për projektin e ndarjes së mbeturinave.

Realizimi i dy çerdheve të reja në financim nga MASHT-i, një në qytet dhe një në fshatin Batllavë.

Shkolla në fshatin Llugë, projekti është në fazën e tretë dhe përfundimtare e përmbylljes së projektit të ndërtimit të shkollës, financuar nga MASHT-i.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE-DSHMS

Ka kryer një varg punësh dhe projektesh.

Sektori i Shëndetësisë

Vizita në QKMF dhe Shërbime Specialistike:

Total vizita në QKMF 192,617; Emergjenca 59,808 vizita; Kujdesi paliativ, një shërbim i ri që është futur në funksion në Komunën tonë dhe i cili jashtëzakonisht është mirëpritur nga ana e qytetarëve ka kryer 9,568 vizita; Programi për gratë shtatëzana dhe fëmijët 0-3 vjeç 1,152 vizita; Stomatologjia 6,365 vizita; Shërbimet specialistike (Pediatria, Epidemiologjia) 465 vizita; Gjinekologjia dhe materniteti 5,421 vizita / 6 lindje; Laboratori 26,029 pacientë; Radiologjia (RTG, Echo, Mamografi) 18,685 vizita; Shërbimi i insulinave 657 pacientë; Këshillimi për Diabet dhe HTA 4,536; Vaksinimi i rregullt 15,241 vizita; Vizitat sistematike të fëmijëve dhe nxënësve: 3,321

Ka edhe vizita tjera, por unë nuk do ju ngarkoj më shumë sepse do të keni raportin në ueb sajtin e Komunës, përkatësisht në faqen time.

Përveç aktivitetit primar për kryerjen e shërbimeve për qytetarë, janë realizuar edhe një varg investimesh të ndryshme kapitale duke filluar nga ndërtimi i objektit të urgjencës, projekt që ka qenë në bashkëfinancim me Katarin në vlerë prej 1,700,000 €, tashmë e kemi përfunduar dhe është në përdorim për nevojat e qytetarëve por edhe të stafit mjekësor atje.

Furnizim me Pajisje Mjekësore 106,450 € (projekt i realizuar); Furnizim me Oksigjen 6,750 Euro (projekt në realizim); Servisimi i Pajisjeve Mjekësore mbi 35,000 € (projekt në realizim);

-Renovimi i Objekteve Shëndetësore: Renovimi i QKMF dhe Teren 90,000 € (projekt në realizim); Renovimi i hapësirave të radiologjisë 90,000 € (projekt në realizim); dhe ajo që është shumë e rëndësishme kemi një investim në pajisje dhe barna në shumë 443,706 € çka do të thotë po i ofrohemi gjysmë milioni të financimit vetëm për barna dhe reagenca të ndryshëm që janë të nevojshme për qytetarët tanë.

Kanë vazhduar punët në ndërtimin e objektit të Qendrës Rezidenciale që është në ndërtim e sipër që kap vlerën diku 2.500,000 €.

Sektori i Mirëqenies Sociale

Po ashtu kjo Drejtori gjatë këtij viti ka ndarë edhe një shumë të konsiderueshme të subvencioneve dhe atë:

-Subvencionet për OJQ: OJQ Handikos 9,500 Euro; OJQ Autizmi 8,500 Euro; OJQ OFAP: 2,000 Euro

-Ndihma për Familjet në Nevojë: Ndhimë me pako ushqimore 350 familje; Shujta të rregullta ditore 50 persona.

-Strehim Social: Gjatë këtij viti kemi pas të regjistruara 34 raste familje për banim social. Kemi një varg shtëpish të ndërtuara nga shoqata "Jetimat e Ballkanit", faktikisht ky vit po përmbillet me 5 shtëpi të reja që janë ndërtuar dhe kemi vazhduar një varg veprimesh me renovime të shtëpive të atyre të cilët janë në nevojë për përmirësimin e kushteve të banimit të tyre.

Qendra për Punë Sociale

-Shërbimi

Social

Në vitin 2024, janë trajtuar rastet; Dhunë në Familje 83 raste; Fëmijë me aftësi të kufizuara 36 raste të reja, gjithsej 156 raste; Shpallja e personit të vdekur 4 raste; Vërtetim mbi zotësinë

e veprimit 598 raste; Vërtetim për lirim nga shtetësia 20 raste; Vërtetim mbajtës i fëmijëve 15 raste; Konstatime zyrtare 19 raste; Të mitur në konflikt me ligjin 37 raste të reja; Kërkesa për adoptim të fëmijëve 3 raste; Besim i fëmijëve 6 raste; Këshilla martesore 20 raste.

-Shërbimi i Asistencës Sociale

Ky shërbim vepron në kuadër të QPS dhe zbaton Ligjin e Skemës Sociale, i cili ka trajtuar mbi 700 raste gjatë këtij viti.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Është njëra prej drejtorive ku rangojnë shumica e investimeve kapitale.

-Leje Mjedisore Komunale: Kërkesa totale 30, prej tyre në procedurë 7; Të aprovuara 20; Të refuzuara 2; Njoftime 1

-Leje Ndërtimore Komunale: Informatë mbi planin urbanistik 21 kërkesa (18 të aprovuara, 3 të refuzuara); Kushtet ndërtimore 67 kërkesa (25 në proces, 32 të aprovuara, 10 të refuzuara); Lejet ndërtimore: 42 kërkesa (10 në proces, 30 të aprovuara, 2 të refuzuara); Pëlqimi në parim: 84 kërkesa (8 në proces, 70 të aprovuara, 6 të refuzuara)

-Legalizime të ndryshme ; Njoftime për taksat dhe tarifat ; Njoftim për plotësimin e dokumentacionit e kështu me radhë.

-Projektet e Realizuara: Të përfunduara 13 projekte (30.765 km asfaltim total); Në proces: 7 projekte.

-Lista e rrugëve të asfaltuara: Fshatrat Lluga, Gërdoc, Kaçibeg (1.290 km); Fshatrat Dumnicë, Livadicë, Llaushë (0.925 km); Fshatrat Surkish, Sfeqël, Shajkoc, Gllamnik, Konushec, Sibofc , Obrançë, Katunisht, Letanc ,Bradash, Bajqinë , Revuq, Zakut, Dobërdol.

-Projekte në proces: Fshatrat Repë, Tërnavicë , Balloc, Shtedim, Lluzhan, Sallabajë, Penuhë, Shakovicë , Turuqicë, Herticë, Lupç, Majac ; Zgjerimi i rrugës "Xhemail Mustafa" vazhdon edhe vitin e ardhshëm dhe rruga lidhëse nga magjistrerja Podujevë-Prishtinë (1.256 km).

-Këtë vit kanë vazhduar punimet në disa projekte dy Vjeçare 2024/2025;Asfaltimi i rrugëve në Qytet; Asfaltimi rrugës Dumosh-Sfeqël; Asfaltimi rrugës Bradash-Dobratin; Asfaltimi i rrugës Letanc-Llaushe-Dumnicë; Ndërtimi dhe rehabilitimi rrugës Podujevë-Merdare; Rikonstruimi dhe rehabilitimi rrugës Dëshmorët Babatinca; Asfaltimi rrugës Orllan-Kushevice-Nishefc; Ndërtimi nënkallimit dhe rrugës te stacioni i trenit; Asfaltimi rrugës nga Gurëthyesi(Turuqicë) deri në Sahit Llalloshi (Herticë).

-Projekte të tjera; Hartimi i Planit Rregullues të Zonës Industriale, një projekt që pritet të filloj realizimi i tij; Projekte të ndryshme infrastrukurore(Serrat dhe kanalizimi në fshatrat Bradash, Letanc, Shajkoc-Batllavë; Rrugët: "Xhemajl Mustafa", "Bedri Bajrami", "Hakif Zejnullahu"; Ndërtimi i Oborrit të Komunës dhe Pishinës Gjysëm-Olimpike; Mirëmbajtja e sistemit të ujitjes, fontanave, dhe lodrave në park; Rregullimi i hapësirave përgjatë Lumit Llap; Shërbime konsulente; Mirëmbajtje infrastrukturash; Regjistrimi i adresave (SIRA).

DREJTORIA PËR PRONË, KADASTËR DHE GJEODEZI

Ka kryer punët dhe aktivitetet si vijon:

-Ka trajtuar 1,753 kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronësisë: 1,621 të aprovuara (92,5%), 125 në procedurë dhe 7 të refuzuara; 670 kërkesa për ndarje, bashkim dhe legalizim të njësive kadastrale; 28 kërkesa për historikë pronësie; 168 kërkesa për regjistrimin e hipotekave; 482 kërkesa për korrigjimin e të dhënave personale; 7 kërkesa për shënimin e urdhërit përmbarrimor; 6 kërkesa për shënimin e masës së përkohshme të sigurisë; 1 kërkesë për lirimin e barrës tatimore; 6,276 kërkesa për çertifikata pronësie dhe shërbime të tjera.

-Aktivitete të implementuara në Sektorin për Pronë: 10 kërkesa për shndërrimin e pronës nga private në pronë shoqërore për rrugë publike; 40 propozim-vendime për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale; 53 njoftime për shfrytëzuesit e pronës komunale; 47 ftesa për takime informuese me shfrytëzuesit; 3 procedura të uzurpimeve për mbrojtjen e interesave të Komunës.

DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

-Investime kapitale: projekti renovimi i hapësirave të Galerisë së Arteve dhe rregullimi i oborrit dhe objektit të vjetër të Komunës; Ndërtimi i Qendrës Multifunktionale, projekt i cili po financohet nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit është në punë e sipër, pritet të përfundojë në mes të vitit 2025; Ndërtimi dhe vendosja e shtatores së Presidentit Ibrahim Rugova; Ndërtimi i terreneve dhe hapësirave sportive, vlerë: 425,000 euro, projekt që vazhdon ende të realizohet; Fillimi i punimeve renovimin e Teatrit Avdush Hasani dhe ndërtimi i një aneksi për nevoja të këtij teatri; Inicimi I procedurës për ndërtimin e Memorialit Afrim Zhitia dhe shtatoren e tij në fshatin Lluga.

-Subvencione: DKRS ka subvencionuar rreth 140,000 euro për OJQ-të në Kulturë, Rini dhe Sport, përmes thirrjeve publike.

Kultura: Organizime kulturore (50 ngjarje):Galeria e Arteve 8 ekspozita gjatë vitit 2024; Manifestime 10 aktivitete kulturore; Ditët e Diasporës; 5 koncerte me artistë të estradës; 8 dokumentarë dhe 10 filma në kinemanë e hapur; 3 panairë libri dhe 2 me produkte artizanale; 4 festivale, përfshirë “Bëje Shqiponjën” dhe “Valët e Llapit”; Pastaj një varg takimesh të ndryshme kulturore sikurse rasti me takimet e kulturës “Kadri Kadriu”, po ashtu është mbështetur edhe një numër i madh i aktiviteteve të ndryshme sportive, sikurse edhe aktivitete që lidhen me teatrin, ku janë realizuar 2 premiera dhe 34 repriza për të rritur e fëmijë. Trupa teatrore po ashtu mori pjesë në 4 festivale teatrore. Në këtë vit për Bibliotekën janë siguruar 1,100 tituj të rinj, gjithsej 6,500 ekzemplarë; 566 lexues regjistruar; 4,794 studentë kanë përdorë hapësirën e bibliotekës për lexim, ndërsa 920 nxënës kanë përdorë këndin për fëmijë; Janë realizuar një varg ekspozitash të librit, por edhe një varg aktivitete tjera të cilat lidhen me arkivën, pastaj Institutin për Krimet e Luftës, aktivitete e ndryshme rinore, por edhe ngjarje të ndryshme sportive në të gjitha fushat.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE MBROJTJES DHE SHPËTIMIT

Në vazhden e shumë aktiviteteve të veta po i përmendi disa që janë realizuar gjatë këtij viti: Ndërtimi i trotuareve, janë realizuar 2,765 m²; Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Llap në qytet, janë rregulluar 800 m brigje të lumit; Hartimi i projektit për rregullimin e lumenjve , është në procedurë të tenderimit; Riparimi i rrugëve të asfaltuara, anë realizuar 553.00 m³ asfalt; Ndërtimi i ndriçimit publik, janë realizuar 2,766m ndërtim të ri të ndriçimit publik; Rregullimi i infrastrukturës së varrezave të qytetit, është në procedure; Ndërtimi i kanalizimit nga fshatrat Lluzhan, Lupq dhe Gërdoc-Lluzhan (kolektori) vazhdon një projekt me financa vetanake të Komunës; Rregullimi i rrugëve me zhavor në fshatrat Sylevicë, Llapashticë, Metergoc, Brainë – Metergoc , Bllatë, Batllavë, Majac, Herticë, Godishnjakë e kështu e radhë; Janë ndërtuar 210 m mure mbrojtëse, kanal kullues 455 m; Jnaë ndërtuar 4 ura në fshatrat Majac, Lluga, Pollatë, qytet te Bebusht; Ndërtimi i rrugëve me kubëza, janë ndërtuar 51 rrugë me 9,824.4 m³ kubëza; Është kontraktuar mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve; pastaj mirëmbajtjen e infrastrukturës publike; Mirëmbajtja e lumenjve, Janë realizuar 2,406.5 m pastrim dhe rregullim të shtratit të lumenjve; Mirëmbajtja e sistemit të ujitjes; Furnizimi me drunj dekorativ, me 1,150 drunj dekorativ në qytet(në veçanti në rr” Skënderbeu”) dhe një pjesë e tyre nëpër fshatra; Trajtimi i qenve endacak, janë trajtuar 300 qen endacak; Është bërë furnizimi me lule, anë mbjellë mbi 13,000 lule të llojeve të ndryshme në qytetin e Podujevës dhe pjesën periferike; Mirëmbajtja e ndriçimit publik, janë ndërruar 536 trupa ndriçues të dëmtuar dhe është bërë intervenimi në ato defekte që janë paraqitur në këtë sistem, gjë që edhe gjatë këtyre ditëve kemi probleme jashtëzakonisht të mëdha por fatmirësisht mund të ju informojë se sot është kthyer vendimi lidhur me atë kontratë sepse ka qenë lënda në ankesë në OSHP dhe besoj se do të lidhet kontratë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe besoj se të gjitha ato hapësira ku janë këto probleme së

shpejti do ti sanojmë. Është bërë mirëmbajtja e trotuareve, diku 2,099 m³ trotuare, janë ndërruar 155 m skajore, e kështu me radhë. Janë dhenë një varg i hapësirave publike në shfrytëzim afatshkurtër – sezonal, diku 39 kërkesa; Janë dhenë leje 71 transportuesve të ndryshëm (autobus, minibus, autotaksi); kemi pas 634 raste të intervenimeve të zjarrfikësve dhe ndërtimi i shtigjeve të biçikletave ku janë realizuar gjatë këtij viti prej 1,240 m ; Është punuar diçka në vendosjen e shenjëzimeve horizontale dhe vertikale në qytet dhe fshatrat përreth.

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Punët dhe aktivitetet :

-Inspeksioni i Tregut: Inspektime me Procesverbal 389; Ankesa/Kërkesa 60; Ankesa të Zgjedhura 30; Largimi i objekteve të përkohshme/kiosqeve 25; Largimi i pengesave 10; Gjoha Mandatore 14; Kontrollle të Përbashkëta 1556; Aksione me Policinë 5;

-Inspeksioni i Mbrojtjes së Mjedisit: Procesverbale 169; Kontrollle Inspektuese të Përbashkëta 245; Gjoha Mandatore 27; Ankesa/kërkesa Zyrtare 14; Raporte të ndryshme 62 e kështu me radhë.

-Inspeksioni i Komunikacionit: Inspektime me Procesverbal 3; Ankesa/Ankesa Verbale 17; Gjoha Mandatore 2, “dmth kanë qenë tepër të suksesshëm, dy gjoha i kanë shqiptuar gjatë tërë vitit”; Inspektime të Përbashkëta 210; Inspektime me Policinë 25; Raporte mujore 11.

-Inspeksioni i Pylltarisë: Procesverbale 39; Ankesa 94; Kontrollle të Përbashkëta 615; e kështu me radhë.

-Inspeksioni i Ndërtimit: Inspektime me Procesverbal të inspektimeve të objekteve me leje 40; Rrënimi i objekteve pa leje 3; Ankesa 1; Gjoha Mandatore 4; Kontrollle të Përbashkëta 51; Aksione me Policinë 25.

DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Punët dhe projektet e realizuara:

-Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Subvencione për perimekulturë: Vlera: 357,142 €, ku kanë përfituar 35 fermerë përkrahur me serra 500 m²; 85 fermerë përkrahur me serra 50 m².

Subvencione për blegtori: Vlera: 385,714 €; 154 fermerë janë përkrahur me një mëshqerrë; Subvencione me mekanizëm bujqësor: Vlera: 142,857 €; 103 fermerë janë përkrahur me mekanizëm të ndryshëm bujqësorë.

Subvencione për pemëtari: Vlera: 71,428 €; 10 fermerë përkrahur me fidane të feferonave; 4 fermerë me fidane të dredhëzës; 4 fermerë me fidane të mjedrës.

Subvencione për bletari: Vlera: 42,257 €; 17 fermerë përkrahur me duplikatorë elektrike; 16 fermerë me koshere.

Ky ka qenë viti që për herë të parë u ngritë platforma e tregut online për produktet bujqësore. Po ashtu ka pas edhe një numër aktivitetesh që lidhen me këtë Drejtori, ka pas diku 6765 që kanë marr certifikatën e regjistrimit NIF dhe kemi pas 38 vendime për ndërrimin e destinimit të tokës, nga ajo bujqësore në tokë ndërtimore.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

- *Turizmi*: Puna për projektin e rregullimit të hapësirave në fshatrat Dumnicë e Poshtme, Kërpimeh, Bajçinë, Llapashticë dhe Sfeqël ka nisur me vlerë 100,000 €, është një projekt që është duke u trajtuar në OSHP.

- Broshura informuese: Projekti “Promovimi i potencialit turistik dhe ekonomik të Komunës së Podujevës” është në përfundim.

- Zona Industriale: Marrëveshje me MINT, po shpresojmë që së shpejti të kalohen pengesat e ankesve dhe fillon realizimi i këtij projekti. Është prej projekteve kapitale më të rëndësishme për Komunën tonë dhe është investim komplet i Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë .

-Tregu i Gjellbër: Kemi lidhur një Memorandum Mirëkuptimi me MZHR për ndërtimin dhe rregullimin e tregut me vlerë 1,440,787.30 € dhe është një prej investimeve kapitale që do të jetë në dispozicion për të gjithë ata që kanë për ta pasur mundësinë për ta shfrytëzuar.

-Jemi në fazat përfundimtare të trajtimit të aplikimeve për "Parkingun nëntokësor", fjala është për hapësirën në mes dy komunave. Po shpresojmë nëse do të kemi mundësinë që pas 3 ose 4 herë të përsëritjes së procedurave, eventualisht ta lidhim kontratën me operatorin.

-Kemi pas një mbështetje për bizneset lokale, rreth 90 biznese, duke përfshirë start-up të ndryshme në vlerë prej 142,200 €.

-Mbështetje për fermerë, 49 përfitues janë mbështetur me serra 100m² nga bashkëpunimi me Islamic Relief Kosova në vlerë totale 58,000 €.

-Subvencionimi për Eko Llapi, një ndërmarrje e re, të cilës i është mundësuar për blerje të mjeteve të punës në vlerë prej 247,800 €, po ashtu i janë dhënë edhe një varg vegla pune në vlerë 9,900 €.

-Subvencionim për NPL Stacioni i Autobusëve, vlera financiare prej 30,000 €, me qëllim që të bëhet funksionalizimi i kësaj ndërmarrjeje.

-Po ashtu kjo Drejtori ka qenë pjesë e projektit Festivali "Ditët e Diasporës" dhe "Ditët e Fundvitit", ku janë mbështetur për bizneset e ndryshme vendore.

-Strategjia e Turizmit 2025-2028, është në procedurë të e prokurimit hartimi i kësaj Strategjie në vlerë prej 15,000 €.

Këto janë projektet që i kemi realizuar gjatë vitit 2024, projektet të cilat kanë pas buxhet komunal por edhe buxhet nga ministritë e ndryshme të linjës. Ajo çka është shumë e rëndësishme, mund të themi se jemi prej atyre komunave në saj të një bashkëpunimi të mirë që kemi pas me Nivelin qendror po përmbyllim një vit ku kemi përfitur nga ministritë e linjave përmes memorandumeve të ndryshme të bashkëpunimit me rreth 14.5 milion euro.

Në total kemi pas buxhet kapital rreth 9 milion euro, ndërsa kemi fituar diku rreth 14.5 milion euro. Kjo sigurisht që na ka ndihmuar shumë në realizimin e shumë projekteve komunale. Unë besoj se ky vit ka qenë ndër vitet më të suksesshme në aspektin e realizimit të shumë projekteve të ndryshme përkundër faktit që gjatë këtij viti kemi pas edhe sfida të ndryshme. Një prej sfidave kryesore kanë qenë ankesat e ndryshme të paraqitura nga operatorët e ndryshëm. Tashmë rregullativat ligjore në fuqi parashohin që çdo njëri operator ekonomik që mund të jetë humbës qoftë me çmim më të lartë apo më të ulët ka mundësinë e parashtrimit të ankesës. Në momentin që një projekt shkon në procedurë ankimore minimalisht kjo procedurë e shqyrtimit dhe vendosjes zgjatë 3 muaj në kuadër të këtij procesi. Kësaj radhe kemi probleme me dy projekte që janë shumë të rëndësishme, fjala është për Parkun Industrial nga Ministria e Industrisë i cili është në proces të ankimimit dhe jemi në pritje që sa më shpejtë të përfundojë ky proces. Të njëjtin fat ka pas edhe projekti i ndërtimit të Pishinës gjysmë olimpike, ku tenderi është shpallur nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe vlera e projektit sillet 3.5 milion euro, është në fazë të ankimimit, dhe po shpresojmë se nuk do të vonohet shumë. Sfidë tjetër është edhe fakti që jo rrallë herë kemi telashe me operatorët ekonomik, përkundër faktit që nënshkruajnë kontratat kemi vonesa të shpeshta, për arsye se shpesh operatorët ekonomik zgjerohen në shumë projekte dhe pastaj hasin në vështirësi në rumbullaksim të projekteve të tilla. Një prej situatave të tilla e kemi rrugën që lidh rrugën magjistrale Podujevë-Prishtinë me qytetin dhe që mendojmë se pasi që të realizohet ky projekt do të jetë shumë i rëndësishëm për arsye se do ta zhbllkojë trafikun përbrenda qytetit në masë të madhe, por që kemi pak ca neglizhime në kuptim të realizimit të projektit për shkak të pamundësisë që operatorët ekonomik të ecin pak më shpejt, sikurse e kemi të njëjtin problem edhe me realizimin e fushave sportive që faktikisht edhe në këtë vit nuk po përmbyllet për shkak të neglizhencës së kompanisë punë kryese. Përndryshe mund të themi që ka qenë vit i mbarë dhe i suksesshëm, sepse ky vit në veti bartë dhjetëra projekte që kalojnë vlerat e shumë milionësh dhe kjo mendoj se gjatë i ka munguar komunës së Podujevës dhe tashmë i ka këto projekte dhe është duke realizuar dita ditës. Çështje tjetër që ia vlen ta diskutojmë

bashkë me ju sot, sikurse se keni e parë është që kemi filluar tu hapim rrugë ndërtimeve të larta në Komunën tonë. Tashmë, i kemi mbi 5 investitor të ndryshëm të cilët kanë plotësuar kriteret e ndërtimit dhe kanë vazhduar të punojnë me ndërtime të larta. Ne e dimë të gjithë se kjo fushë ka qenë relativisht e kufizuar në Podujevë dhe gjatë kohës ka qenë e ngulfatur. Fatmirësisht duke iu falënderuar punëve të mira që ka bërë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, por edhe Drejtoritë tjera përkatëse që lidhen e këto projekte. Këto projekte tashmë po vazhdojnë të realizohen dhe ka edhe shumë kërkesa tjera të cilat janë në pritje dhe të cilat sigurisht në kohë reale do tu jepet përgjigja adekuate në mënyrë që tu hapet rrugë edhe më tutje këtyre ndërtimeve. Ajo që është shumë e rëndësishme dhe që gjithherë e kam dashtë dhe e kam pritur e po besoj që edhe qytetarët e kanë pritur është që të kemi sa më shumë vinça ndërtues në Komunën e Podujevës. Gjatë një kohë thuajse 20 vite patën mbete dy vinça dhe ende janë aty, ashtu i kemi gjetur dhe vazhdojnë të mesin ashtu sepse i kanë shkelur të gjitha kriteret dhe kanë problem të shkojnë më tutje, ndërsa kë tonat që i kemi lëshuar gjatë këtyre viteve të fundit po ecin përpara dhe ka progres në këtë aspekt, për çka do të bëjmë çmos që investitorëve potencial t'iu krijojmë hapësirë dhe kushte. Viti që po hyjmë mendojmë se ka me qenë vit me një varg suksesesh sepse presim shumë shpejt të nënshkruhet kontrata për fillimin e punëve për ndërtimin e Digës në fshatin Pollatë- Liqenin /akumulacionin, që ka me qenë një prej projekteve jetike për qytetarët e Podujevës sepse do të jetë projekti i cili ka për të zgjidhur problematikën e ujit të pijshëm, ujë të cilin e kemi në mungesë të madhe në Komunën tonë, jo vetëm fshatrat por edhe qyteti gjatë stinës së verës.

Një tjetër projekt me rëndësi që jemi në pritje të nënshkrimit të kontratave të fillimit të punimeve është impianti i ujërave të zeza, një projekt i Qeverisë cili sigurisht do të kalojë vlerën mbi 35 milion euro. Projekti pritet të realizohet në pjesën e poshtme të territorit të Komunës tonë, përkatësisht te lagja e pirëve, ku do të bëhet fabrikimi i të gjitha ujërave të zeza, sepse tashmë kemi nënshkruar kontratën për kolektorin për të mbuluar komplet territorin e Komunës. Ju jeni në dijeni se kemi gjetur një projekt për të cilin është marrë një kredi në emër të atij kolektori në vlerë prej 5.3 milion euro me të cilën shumë të mjetete financiare janë realizuar përafërsisht 15 km kolektor. Duke pas parasysh ritmin çfarë ka ecur me vlerën shumë e lartë të realizimit të atij projekti, ne nuk kemi vazhduar më tutje që qytetarët tanë t'i fusim në borxhe por e kemi mbyllur atë projekt e atë kredi dhe kemi ndarë mjete buxhetore për të vazhduar realizimin e atij projekti. Tashmë kemi ndarë një shumë prej 3 milion euro me të cilën po shpresojmë se do ta përmbyllim komplet rrjetin e kolektorit në nivel komune dhe nëse do të ec shpejt procesi i impiantit të ujërave të zeza do të jetë një zgjidhje fatlume për qytetarët tanë, sepse do të largojmë rrjetin e ujërave të zeza nga rrjedhat ujore, gjendje kjo e cila seriozisht ka dëmtuar ekologjinë e komunës tonë. Një tjetër projekt që po ashtu kemi diskutuar dhe që po e bëjmë për herë të parë publike është studimi i fizibilitetit për ngrohjen qendrore të qytetit të Podujevës. Këtë nuk e kemi bërë ende publike sepse mendonim ta bënim publike gjatë kohës së fushatës së zgjedhjeve, por që të mos na thuhet se është vetëm fushatë po e bëj paraprakisht publike sepse jemi duke punuar në këtë projekt dhe shpresojmë se së shpejti do ta kemi fizibilitetin si dhe shpresojmë se do të gjejmë solucionin më të mirë të përshtatshëm për sigurimin e ngrohjes për qytetarët e Komunës së Podujevës me çmime sa më të përballueshme. Këto janë disa prej punëve dhe projekteve të cilat bashkërisht me ekipin tim kemi arritur ti shtyjmë deri këtu dhe po besoj se suksesshëm po përmbyllim këtë vit.

Ju falënderoj shumë për vëmendjen dhe jam i hapur për çfarëdo pyetje nga ana e juaj.

z. Nysret Restelica, nga Podujeva, theksoi, fillimisht ju përgëzoj për punën e bërë. Kam një pyetje për Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, afër urgjencës së re menjëherë në anën e majtë, rruga "Hys Popova" i kemi rreth 10 ha tokë ne si familje Restelica, pastaj edhe familjet Blakçori, sipërfaqe që shtrihet deri te hekurudha, te varrezat e qytetit. Pyetja është se nuk jam në dijeni se a ka ndodhë ndonjë gabim që ajo pjesë nuk ka hyrë në Hartën Zonale dhe me kanë thënë se deri në vitin 2030 nuk do të revidohet

dokumenti. Pyetja është se a do të ketë revidim të HZ vitin e ardhshëm sepse ajo sipërfaqe po përdoret vetëm për bari dhe asgjë tjetër.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, tashmë jeni në dijeni se kemi aprovuar Hartën Zonale-HZ dhe vitin e ardhshëm jemi në vitin e tretë të zbatimit të saj. Pas vitit të tretë ne kemi të drejtë ta rishqyrtojmë HZ, por ajo që është shumë e rëndësishme është se HZ është hartuar bazuar në një Plan Zhvillimor Komunal që ka qenë i vjetruar. Me ardhjen tonë në pushtet e kemi gjetur në fazën që ka ecur bukur gjatë procesi i saj dhe për ta kthyer në pikën zero na nevojiteshin vite të tjera për ta shtyrë atë përpara, kështu që patëm planifikuar që më mirë të kemi diçka me disa defekte të vogla se sa mos të kemi asgjë. Po mos të ishte ajo Hartë Zonale këtyre ndërtimeve sot nuk do ishin pasur mundësi tu hapnim rrugë dhe shumë punëve tjera të cilat janë planifikuar në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, prandaj ne kemi qenë të detyruar ta shtyjme tutje HZ. Është fat i madh, tashmë unë kam shpall Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal- PZHK, sot është hapur tenderi dhe shpresoj se i tërë procesi do të ec si duhet dhe kryhet Plani Zhvillimor Komunal, i cili për nga pesha është kushtetuta e një komune në kuptimin e ndërtimit dhe mbarëvajtjes së proceseve të ndryshme, si mjedisore ashtu edhe ndërtimore dhe tjera. Prandaj me Planin Zhvillimor Komunal pas aprovimit ne i hapim rrugë revidimit dhe ndryshimit të Hartës Zonale. Dua të theksoj se ndryshimi i HZ nuk shkon në vitin 2030, por unë besoj se fundi i vitit të ardhshëm na e krijon mundësinë që ta kemi PZHK-në dhe me këtë dokument ne e hapim perspektivën e ndërtimit dhe zhvillimit të hapësirës urbane dhe të fshatrave përreth. Me këtë PZHK planifikoj që edhe rajoni i fshatit Orllan të përfshihet dhe t'i hapet perspektivë asaj zone, e jo të mbetet mbyllur qysh ka qenë deri tash, sepse unë e di se shpesh herë opinioni publik na ka akuzuar pse nuk po lejohen ndërtimet atje, por ne kemi qenë të kufizuar prej rregullativave ligjore që janë në fuqi dhe nuk kemi pasur mundësi tu hapim perspektivë. Me PZHK posa të aprovohet mendojmë t'i hapim perspektivë çdo zone dhe hapësirë të Komunës.

z. Bejtush Dushi nga Podujeva, theksoi, kam shqetësim të hapësirës të rreth rrotullimi të Qershiat e fshatit Llapashticë pasi që fëmijët shkojnë dhe kthehen nga shkolla dhe është rrezik shumë i madh deri sa ta kalojnë atë. Aty është shumë e nevojshme ndërtimi i një nënkalimi. Vozitja e automjeteve është jashtë çdo rregulli dhe mendoj se Komuna do të ishte e nevojshme të caktoj aty dy policë për të shqiptuar gjëra ndaj vozitësve të pandërgjegjshëm. Një ditë pas murmurimeve është prishur rrjeti elektrik në atë pjesë dhe lagja afër shtëpisë time nuk ka rrymë fare dhe fatkeqësia është se shumë banorë në atë pjesë kanë dalë jashtë vendit dhe qentë po strehohen nëpër oborre të tyre dhe kjo po paraqet shumë rrezik si për banorët, në veçanti për fëmijët. Unë edhe më parë pata diskutuar nevojën për sigurimin e një autobusi sepse është pak larg për fëmijët tanë shkojnë në shkollën " Ibrahim Rugova". Unë ju përgëzoj për investimet dhe për këtë ju këna votuar dhe do të ju votojmë prapë.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, sigurisht jeni në dijeni se çështja e rrugës magjistrale është në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës, por gjithsesi ne do ta evidentojmë si kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe këtë do ta trajtoj me Zëvendësministrin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe besoj se nuk është punë që nuk mund të bëhet. Mirë do të kishte qenë që kjo në fillim të planifikohej nga ata përpara që kanë bërë planifikimet, por tash duhet shikuar se me cilin variant të shkohet aty me nënkalim apo mbikalim, por si kërkesë nuk mendoj se është kërkesë që nuk mund të realizohet. E dyta, ndriçimi publik, e theksova më herët që kemi pas telashe me projektin e rregullimit dhe mirëmbajtjes së ndriçimit publik. Në muajin qershor është hap tender për këtë projekt dhe projekti ka shkuar në ankesa dhe sot ka arritur vendimi final se është aprovuar ai vendim që kemi marr ne si Komunë dhe besoj se këto 2-3 ditë do ta nënshkruajmë kontratën. Në terren ka shumë defekte të ndriçimit publik, kemi një varg fshatra që kanë ankesa për shkak të dëmtimit të tyre nga rrufeja ose që kanë pësuar nga probleme të ndryshme teknike. Një rast në fshatin Batllavë tërë ditën dhe natën është ndezur nuk fiket fare për shkak të një siguresë, por besoj se këto do t'i mënjanojmë dhe do të zgjidhet së shpejti ky problem. Si

çështje e tretë ishte shkolla, nëse nuk gaboj edhe në vitin e kaluar kam theksuar se nuk e kam telashe të ndërtoj shkollën, por problem e kam hapësirën, nuk kam pronë publike aty. Sikur të kishim pronë publike shkollën do ta ndërtoja që moti aty. Ajo pjesë ka nevojë të ketë shkollën aty. Për transport publik dua të ju njoftoj se ne e kemi një Stacion të Autobusëve që si ndërmarrje komunale sigurisht jeni në dijeni se në çfarë gjendje e kemi gjetur, aty ka pas një numër të autobusëve por nuk jemi në dijeni se çfarë ka ndodhë me ta. Ne që tani e kemi marrë një donacion një autobus që është pak më i gjatë dhe i cili për këto rrugët tona është problem të qarkullojë por donacioni është shumë i mirëseardhur dhe ne jemi duke analizuar bashkë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtimit si të zgjedhim këtë problem. Jam shumë i interesuar që së paku të marrim një kredi nga Banka Botërore apo kushdo që mund ta marrim dhe t'i sigurojmë 15 autobusë për Podujevën, sepse i kemi edhe disa linja që po kemi probleme me operatorët privat të transportit, sikurse që kemi rastet në fshatrat Dumnicë, Siboc, Pollatë dhe jemi duke shqyrtuar mundësinë për zgjidhjen e këtij problemi.

Unë mendoj që për vitin tjetër nga Drejtoria e Arsimit atyre fëmijëve tu sigurohet transporti për në shkollë për të mos rrezikuar rrugës, nëse nuk bëhet ndonjë zgjidhje tjetër edhe pse jeni në dijeni se ajo rrugë ka një varg pengesash që i kemi vendosur për të penguar vozitjen e shpejtë, por gjithashtu është sinjalistika horizontale dhe vertikale e mirë, megjithatë gjithmonë kemi vozitës të papërgjegjshëm që tejkalojnë rregullat e lejuara në komunikacion.

Nëse nuk ka tjerë të interesuar, më lejoni që të ju falënderoj të gjithë juve për kohën kushtuar këtij takimi, gjithashtu ju uroj festat e fundvitit, paqi shëndet e suksese në familjet tuaja.

Kryetari e përmbylli takimin duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin.

Mbledhja përfundoi në orën 15.40

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr.Prot.01-060/04-0080831/24
Podujevë, datë:23.12.2024**

